

VENDIM
Nr. 57, datë 2.4.2024

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 253, DATË 23.8.2023, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘ERSEKA SOLAR PARK 2’ SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 20 mw (AC)”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.4.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 165/5 prot., datë 29.5.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 253, datë 23.8.2023, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Erseka Solar Park 2’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 20mw(AC)”’.

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 253, datë 23.8.2023, ka vendosur të licencojë shoqërinë “Erseka Solar Park 2” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 20 mw (AC), për një afat 30-vjeçar, duke i lënë kusht shoqërisë të informojë ERE-n çdo 3 (tre) muaj, në lidhje me fillimin e punimeve të ndërtimit të centralit fotovoltai, deri më datë 21.2.2024.

- ERE, me shkresën nr.165 prot., datë 16.1.2024, i kërkoi shoqërisë informacion, në lidhje me fillimin e punimeve të ndërtimit të centralit fotovoltai, pasi shoqëria nuk kishte informuar sipas afatit të përcaktuar. Shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE nr.165/2 prot., datë 19.1.2024, depozitoi vendimin e KKT-së, gjithashtu ka informuar se është në pritje të zbardhjes së lejes dhe po ashtu është në proces të përgatitjes së dokumentacionit për të aplikuar për një VNM të re.

- Në vijim, ERE, me shkresën nr. 165/3 prot., datë 29.2.2024, i kërkoi shoqërisë të depozitojë VNM-në e re pasi në shkresën e fundit shoqëria shprehet se është në proces të përgatitjes së dokumentacionit për të aplikuar. Në përgjigje, shoqëria, me shkresën nr. 165/4 prot., datë 6.3.2024, ka depozituar aplikimin nr. AN040320240002 dhe mandatin bankar për pagesën e tarifës së aplikimit për VNM në datën 26.2.2024.

- Gjatë marrjes së vendimit nr. 235/2023, shoqëria “Erseka Solar Park 2” sh.p.k. dispononte VNM të vlefshme, si e tillë i është lënë kushti të informojë çdo 3(tre) muaj, në lidhje me fillimin e punimeve për ndërtimin e centralit fotovoltai brenda afatit të vlefshmërisë së VNM-së, pra brenda datës 21.2.2024.

- Aktualisht, duke marrë në konsideratë që ka përfunduar VNM-në dhe subjekti ka bërë me dije se nuk ka nisur ende punimet por ka aplikuar për një VNM të re, por ende nuk e ka depozituar atë, si e tillë vlerësohet të ndryshohet pika 2, e vendimit të Bordit nr. 253/2023, duke i vendosur kushtin shoqërisë përpara se të fillojë veprimtarinë e operimit/ushtrimit të energjisë elektrike, shoqëria “Erseka Solar Park 2” sh.p.k. të depozitojë në ERE VNM-në e re.

- Në nenin 113, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e ndryshimit të një akti, me nismën e vet organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 253/2023, ndryshon dhe bëhet:

“2. Përpara fillimit të operimit/ushtrimit të veprimtarisë së energjisë elektrike ,shoqëria “Erseka Solar Park 2” sh.p.k. të depozitojë në ERE VNM-në e re.”.

2. Pika 3, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 253/2023, ndryshon dhe bëhet:

“3. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të depozitimit të VNM-së së re.”.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË
Erjola Sadushi